

## **Platforma CiviKos Konkurs për praktikantë/e**

Platforma CiviKos ([www.civikos.net](http://www.civikos.net)) është iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, e themeluar për të krijuar dhe avancuar një mjedis të përshtatshëm formal për bashkëpunim të sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore të Kosovës. Me një rritje të vazhdueshme dhe aktualisht me 210 organizata anëtare, Platforma CiviKos është e angazhuar në thellimin e bashkëpunimit në mes të organizatave anëtare, si dhe me autoritetet publike dhe palët tjera me rëndësi në zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë.

Për të fuqizuar organizimin e brendshëm dhe komunikimin e vazhdueshëm me të gjithë partnerët e saj, Platforma CiviKos kërkon të angazhojë praktikant/e me orar të pjesshëm.

### **Praktikant/e**

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë**

- Mirëmban bazën e të dhënave në CiviKos;
- Përkrah aktivitetet e Sekretariatit të Platformës CiviKos;
- Ndihmon në koordinim të aktiviteteve të projekteve të CiviKos
- Merr pjesë në aktivitetet e anëtarëve të Platformës të ndërlidhura me aktivitetet e Platformës CiviKos;
- Merr pjesë në aktivitetet e Platformës CiviKos dhe Qeverisë që kanë të bëjnë me dialogun dhe bashkëpunimin në mes sektorit të shoqërisë civile dhe qeverisë;
- Ndihmon rreth punëve administrative në Sekretariatit e Platformës CiviKos;
- Angazhime tjera varësisht nga interesi dhe nevojat e projekteve që CiviKos është duke zbatuar.

#### **Kualifikimet e nevojshme**

- Student /e i/e vitit të fundit apo i/e sapodiplomuar në shkencat shoqërore, Fakultetin Juridik apo Ekonomik;
- Njohuri themelore rreth funksionimit të sektorit të shoqërisë civile në Kosovë
- Njohuri të shkëlqyeshme në të folur dhe të shkruar të gjuhës shqipe dhe angleze (njohja e gjuhës serbe është përparësi);
- Njohuri të plota të punës me kompjuter.
- Përparësi kanë vullnetarët dhe anëtarët e angazhuar dhe më herët në aktivitetet e Platformës CiviKos dhe të organizatave anëtarëve të Platformës CiviKos

#### **Ne ofrojmë:**

- Mundësi rritjeje profesionale;
- Kushte shumë të mira të punës;
- Kompensim të shpenzimeve të praktikantëve.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë:

- Letrën e motivimit (Përse dëshironi të angazhoheni në CiviKos)
- CV-në
- Referencat

**Ju lutëm që dokumentet e plotësuar ti dërgoni në email [info@civikos.net](mailto:info@civikos.net) deri të Premten 08.09.2017 ora 16:00**